

VENDIM
Nr. 144, datë 28.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MATEO & CO” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “MURASI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/3 prot., datë 25.8.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1053 prot., datë 14.8.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, regjistruar pranë QKB-së në datën 20.5.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Në objekt të veprimtarisë së saj, shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka prodhimin e energjisë elektrike.

- Në vijim të depozitimit të kërkesës për aplikim, shoqëria ka dërguar në ERE shkresën e protokolluar me nr. 1053/1 prot., datë 20.8.2020, bashkëlidhur së cilës ka depozituar dokumentacion për qëllime të këtij aplikimi.

- Kontrata nr. 1768 rep., nr. 784/3 kol., datë 26.7.2017, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Murasi” me kapacitet prodhues 2 mw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, aplikuesit “MATEO & CO” sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë ripërsëritjeje.

- MIE ka dhënë për këtë projekt, miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.7.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, qarku Shkodër”.

- Shoqëria ka paraqitur urdhrin e ministrit të Mjedisit nr. 116, datë 14.4.2017, “Për vijimin e procedurave për heqje nga fondi pyjor kullosor publik të një sipërfaqeje prej 0.1398 ha në funksion të ndërtimit të HEC ‘Murasi 1 dhe 2’, në kaskadën e lumit ‘Cemi i Selcës’, nga shoqëria ‘MATEO & CO’ sh.p.k., në Bashkinë Malësi e Madhe”.

- Shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik”, me nr. 2299 prot., datë 1.6.2017, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit. Afati i kësaj kontrate ka qenë 1-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj (1.6.2017).

- Aplikuesi ka depozituar dhe kontratën e qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik”, me nr. 6418 prot., datë 8.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e

Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, me afat 5-vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.

- Shoqëria ka depozituar dhe vërtetimet në dokument hipotekar të lëshuar nga ZVRPP Malësi e Madhe, datë 29.5.2017, që korrespondojnë me zonën ku do të shtrihet projekti.

- Shoqëria “MATEO & CO” sh.p.k. ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. 27446/2 prot., datë 21.11.2016, “Miratim pikë lidhje”, drejtuar shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., ku përcaktohet se HEC-i, do të lidhet me rrjetin shpërndarës në linjës 35 kV, të n/stacionit Tamarë.

- Shoqëria ka paraqitur “Leje për përdorim të burimit ujor” me nr. serie 00050, nr. 179/10 prot., datë 20.4.2017, të miratuar nga KBU Drin–Bunë, me vendimin nr. 11, datë 10.4.2017, për shoqërinë “MATEO & CO” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e HEC “Murasi”, duke përdorur burimin ujor Lumin Cemi i Selcës, degë e Lumit Cemi i Bashkuar. Në këtë leje citohet se periudha e vlefshmërisë së saj është deri më 9.4.2022. Në këtë leje rekomandohet të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike. Aplikuesi duhet të japë shpjegim në lidhje me kohëzgjatjen e vlefshmërisë së kësaj leje.

- Shoqëria ka paraqitur VNM-në paraprake lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. 2829 prot., datë 2.12.2016 dhe nr. 712 identifikimi dhe nr. 59 vendimi, për personin juridik “MATEO & CO” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin ‘Ndërtim-operim i HEC ‘Murasi’, me kapacitet 2000 kw.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga rregullorja, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

Mungon dokumentacioni që lidhet me parashikimet e nenit 9, pika 2, germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata): plotësuar pjesërisht. Nga ekstrakti historik i QKB-së i shoqërisë rezulton se selia e shoqërisë është në Shkodër, në vijim do t’i kërkohej që të sjellë vërtetimet e gjendjes gjyqësore të drejtuesve të shoqërisë dhe për këtë qark.

- Neni 9, pika 4.1.4, “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, germa “c”, oponenca teknike e projektit: plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka depozituar në ERE në formatin fotokopje, raportin e oponencës teknike të AKBN-së nr. 2572 prot., datë 20.3.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-it “Muras” miratuar nga MEI me miratimin përfundimtar nr. 3719/13, datë 13.7.2017, “Për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Murasi”, në lumin e Cemit të Selcës, qarku Shkodër. Do t’i kërkohej shoqërisë që ta depozitojë atë të noterizuar/njësuar me origjinalin.

Për gjithë sa më sipër do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2 mw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i Bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti